



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-028
Prishtinë, më 13 korrik 2015, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 13 KORRIK 2015

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Sabri Hamiti Slobodan Petroviq dhe Duda Balje, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Glauk Konjufca, Donika Kada-Bujupi, Slavko Simiq, Valdete Bajrami dhe Müfera Şinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Blerim Latifi dhe Driton Lajqi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe disa përfaqësues të organizatave dhe të Shoqërisë Civile dhe të tjerë, që i përcjellin punimet e Kuvendit.

Mbledhjen e drejtoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 7 korrik 2015,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës dhe
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 7 korrik 2015

Kryesia e miratoi procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 7 korrik 2015, me vërejtjen se duhet të hiqet nga procesverbali vendimi që ka të bëjë me himnin për nder të nobelistes dhe figurës kombëtare Gonxhe Bojaxhiu (Nëna Terezë), ngase nuk ishte marr në atë mbledhje.

Procesverbali i datës 7 korrik 2015 është korrigjuar, sipas vërejtjes së lartshënuar.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryesia, me propozimin e Kryetarit të Kuvendit, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare e radhës të mbahet të enjten, më 16 korrik 2015, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Zgjedhja e Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për sigurimet,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat personale,
10. Kërkesa e deputetes Albulena Haxhiu, e mbështetur nga 5 deputetë nënshkrues për debat parlamentar lidhur me veprimtarin e misionit të BE-së në Republikën e Kosovës.

3. Shqyrtimi i propozimeve, kërkesave dhe njoftimeve

1. Kërkesa e deputetes Albulena Haxhiu, e mbështetur nga 5 deputetë nënshkrues, për debat parlamentar lidhur me veprimtarin e misionit të BE-së në Republikën e Kosovës

Kryesia kërkesën e lartshënuar e radhiti në rend të ditës për seancën plenare të radhës, që do të mbahet më 16 korrik 2015.

2. Kërkesë për mbulimin e shpenzimeve të akomodimit të Komisionit për Integrim Evropian të Kuvendit të Shqipërisë, që do ta vizitojë Kuvendin e Republikës së Kosovës më 20-21 korrik 2015

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Komisionit për Integrim Evropian të Kuvendit të Republikës së Kosovës për mbulimin e shpenzimeve të akomodimit për anëtarët e Komisionit për Integrim Evropian të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, që do ta vizitojë Kuvendin e Republikës së Kosovës prej 20-21 korrik 2015.

2. Administrata e Kuvendit ngarkohet që ta zbatojë këtë vendim.

3. Njoftimi i Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit për vizitën zyrtare të realizuar në Mal të Zi prej 17-19 qershor 2015.

Kryesia u njoftua nga Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Mal të Zi prej 17-19 qershor 2015.

Kryetari e përfundoi mbledhjen e Kryesisë në orën 11:20 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale